
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.173/19	Data: 12.07.2019	

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 29 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut rishpall:

RISHPALLJE KONKURSI

Drejtoria: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e i/ e Lartë për Pemëtari

Numri i Referencës : RN00005148

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Lloji i pozitës: I karrierës

Orari I plotë: 40 orë në javë

Kategoria Funktionale: Niveli Profesional

Grada: Niveli i koeficient 7,5

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Kohëzgjatja e periudhës provuese : 12 muaj.

Qëllimi i vendit të punës: Të ofrojë informata dhe shërbimet e trajnimit për fermerët dhe bashkësitë rurale për zhvillimin e pemtarisë në Komunë.

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Koordinon dhe mbikëqyrë në shkallë komune të gjitha programet për zhvillim ne sektorin e pemëtarisë.
2. Te ofroj informata dhe shërbimet e trajnimit për pemëtarët ne nivel Komune ;
3. Bënë mbledhjen e të dhënave statistikore për zhvillim te sektorit te pemëtarisë ,shpërndan material(broshura,fletëpalosje),ndihmon fermerët për aplikim për Subvencione dhe grande pran MBPZHR;
4. Merr pjesë në ekipet dhe grupet punuese që merren me analizën e programeve dhe rregullave për zhvillimin e bujqësisë;
5. Te punoj me fermerët-pemëtarët për te identifikuar dhe zhvilluar aktivitete qe lidhen me bujqësinë-Sektorin e pemëtarisë,te identifikoj prioritet ne sektorin e pemëtarisë dhe bujqësisë ne përgjithësi;
6. Te përdorë shërbimet aktive te konsulences për te vendosur dhe për te mbajtur marrëdhënie efektive te punës me te gjitha palët e interesuara,duke përfshirë pemëtarët,shoqatat e pemëtarëve, Grupet lokale te veprimit (GLV) etj;
7. Te organizoj ,koordinoj ofrimin e trajnimit formal dhe jo formal duke përfshirë:prezantimet,vizitat ne pemishte,ditën fushore,diskutim ne grupe,takime,konsultime ne zyre dhe me telefon;
8. Të bashkëpunoi në mbledhjen dhe publikimin e informatave nga aktivitetet bujqësore,kryen edhe punë te tjera me kërkesë te mbikëqyrësit;

Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare, fakulteti i bujësisë, drejtimi pemtari-vreshtari dhe të përafërta , 3 vite përvojë pune.
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, diplomat e lëshuara nga institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i, dëshmi për përvojën e punës, certifikata që nuk jeni nën hetime origjinal, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Menaxheri i Peronelit

Fatmir Bytyci

